



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRIZRENT
"UKSHIN HOTI"



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"MAXHI ZEKA"



UNIVERSITETI I MITROVICËS
ISA BOLETINI



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
FEHMI AGANI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

04 tetor 2019

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës

KOMUNIKATË

Universitetet publike, viktimë e mospunës së KSHC-së dhe MASHT-it

Në takimin e sotëm të Konferencës së Rektorëve u shqyrtua përjashtimi i Agjencisë Kosovare për Akreditim nga ENQA (European Association for Quality Assurance in Higher Education).

Rektorët e universiteteve publike shprehin shqetësim të madh, por nuk janë të befashuar me vendimin për përjashtimin e Agjencisë Kosovare për Akreditim nga ENQA.

Përjashtimi i AKA-së nga ENQA është goditje për gjithë arsimin e lartë, sidomos për studentët. Dëmi është shumë i madh.


Përjashtimi i AKA-së është pasojë e politikave të gabuara në arsim. KSHC-ja në vazhdimësi ka qenë e ndikuar prej politikës. Vendimi i ENQA-së është pasojë e degradimit të AKA-së dhe dobësimit të potencialit profesional në AKA, pasojë e tendencës për ta shndërruar arsimin e lartë në biznes dhe në vegël politike. Konsiderojmë se ENQA i ka dhënë kohë të mjaftuar KSHC-së që të stabilizohet por KSHC-ja ka dështuar në këtë aspekt. Mungesa e komisionit të ankesave pranë KSHC-së është njëra prej arsyeve që ka ndikuar në vendimin e ENQA-së. IPAL-i nuk ka pasur mundësi që ankesat e tyre për mosakreditim të programeve të caktuara t'i adresojë pranë komisionit të ankesave, meqë ky komision nuk ishte funksional, pas dorëheqjes kolektive të anëtarëve të komisionit.

Konferenca e Rektorëve, e shqetësuar me veprimet e KSHC-së dhe Ministrisë së Arsimit, ka reaguar me kohë kundër politizimit të AKA-së, gjithashtu ka reaguar kundër dobësimit të AKA-së dhe vendimeve arbitrare të këtij institucioni. AKA-ja nuk ka luajtur rol bashkëpunues dhe konstruktiv me IPAL-in, ajo është sjellë me universitetet publike si gardian burgu, mirëpo edhe përkundër kundërshtive, universitetet e kanë përkrahur AKA-në dhe Raportin e Vetëvlerësimit të AAK-së për ENQA-në.

Konferenca e Rektorëve kërkon përgjegjësi dhe reflektim nga institucionet relevante.

Konferenca e Rektorëve paralajmëron se, menjëherë pas zgjedhjeve të nivelit qendror, do ta mbajë edhe një mbledhje, për të kërkuar nga qeveria e ardhshme seriozitet dhe përkrahje të arsimit, e jo ndikim dhe ndërhyrje në IPAL.

Prof. dr. Fadil Millaku, rektor i UHZ - Pejë


Kryesues i Konferencës së Rektorëve